



Datë: 21.08.2025
Numër Protokolli: 5645/2025

A.nr.1408/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.1408/2025, të datës 18.07.2025, të parashtruar nga ankuesi Xh.V nga Klina, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1408/2025, të datës 18.07.2025, të parashtruar nga ankuesi Xh.V.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Xh.V (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), ka parashtruar ankesë me datë 18.07.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 4842/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1408/2025, kundër Njoftimit të datës 19.06.2025 për rezultatet përfundimtare të kandidatëve fitues, të konkursit me Referencë RN00016224 të datës 27.12.2024 për pozitën “Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën A.nr.1408/2025 të datës 18.07.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Konkursin e datës 27.12.2024; Njoftimin e datës 19.06.2025 për rezultatet përfundimtare; Parashtruesën e ankuesit të datës 23.07.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Njoftimin e datës 29.01.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoi procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankuesit, **sepse**:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më datë 27.12.2024 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00016224, për pozitën e punës *Sekretar i Përgjithshëm*, ku afati për aplikim ka qenë nga data 28.12.2024 deri më 26.01.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se konkursi në fjalë ka përfunduar me datë 19.06.2025 sipas Njoftimit për rezultatet përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm të shpallur nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të MMPHI-së, ndërsa ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 18.07.2025, kundër procedurës së rekrutimit përkatëse, pasi që rezulton se nuk është në mesin e kandidatëve të suksesshëm, me pretendimet ankimore për shkelje procedurale dhe materiale.

Mirëpo, ankuesi me datë 23.07.2026 ka përcjellë parashtresë, përmes së cilës deklarohet se i njëjti është tërhequr nga ankesa e tij e parashtruar me datë 18.07.2025 kundër konkursit me numër Reference RN00016224, për pozitën e punës Sekretar i Përgjithshëm të shpallur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me arsyetimin se nuk ka interes juridik të qëndrojë prapa pretendimeve të tij ankimore dhe ankesës së parashtruar, ndërsa parashtesa e të njëjtit e datës 23.07.2025 në Këshill është protokolluar me numër: 4987/2025.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë; 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë”*, dhe erdhi në përfundimin se ankuesi përmes parashtresës së datës 23.07.2025 me numër protokolli:4987/2025 është tërhequr nga ankesa e tij e datës 18.07.2025 e parashtruar në Këshill, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar parakushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ si në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.1408/2025 të datës 18.07.2025.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1408/2025, datë 21/08/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Xh.V;
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.